VITI 1865

ARTHUR MACMURROUGH KAVANAGH





Përgatiti Mal Berisha

UDHËTARI MË I HABITSHËM QË KA NJOHUR NJERËZIMI, I LINDUR PA DUAR E PA KËMBË, VIZITON BUTRINTIN

Arthur Kavanagh, nga të gjithë udhëtarët që kanë kaluar nëpër Shqipëri është më interesanti, më i habitshmi, më mbresëlënësi. Kishte lindur pa këmbë dhe pa duar, por arriti të bëhej një politikan i suksesshëm. Trashëgimtar i mbretit të Leinsterit, ai vinte nga një familje e fuqishme dhe është vlerësuar si gjeni i kohës së tij.

Ai shërbeu 14 vjet si anëtar i parlamentit dhe udhëheqës i unionistëve nga Irlanda. Kompensimi i shqisave nuk ka gjetur ndonjëherë shpjegim më të mirë sesa në rastin e këtij njeriu.

Ai ka shkruar një libër rreth gjuetisë dhe pikturave në kufijtë midis Greqisë dhe Shqipërisë. Pa këmbë dhe pa duar, ai nuk ishte vetëm një udhëtar që nuk e njihte frikën, por edhe gjahtar i pasionuar, marinar i zoti, peshkatar i mirë, fotograf amator, vizatues i talentuar, autor librash nga më të shiturit dhe babai i shtatë fëmijëve. Ai është një ndër njerëzit që ka udhëtuar më shumë dhe bën pjesë tek ata që njihen si ‘Long Riders’ Guild (udhëtarët e largësive të mëdha me kalë)

Ai është quajtur “KALORËSI ZBULUES MË I HABITSHËM I SHEKULLIT TË NËNTËMBËDHJETË”.

Në librin e tij jep mjaft pamje të bukurisë shqiptare, sidomos gjatë gjuetisë në zona të tilla si Butrinti.